



Rikthehen shpresat e Vllaznise per qendrimin ne Superlige. Ajo ka fituar pasditen e se shtunes 2-1 ndaj Kukësit duke bere qe gara te rihapet pas humbjes se Kamzes ndaj Laçit. Java e fundit e kampionatit kesisoj do te percaktoje çdo gje ne lidhje me qendrimin apo jo te kuqeblove ne kategori. Vllaznia nuk e nisi mire ndeshjen dhe ne minuten e 32-te ka qene Balde ai qe ka shenuar per Kukësin duke e kaluar ne avantazh. Por ne minutat e fundit te pjeses se pare, ndonese Sukaj humbi edhe nje 11-metersh, shkodranet kane shenuar dy gola me ane te Çinarit dhe Kalajes. Ne pjesen e dyte nderkohet rastet nuk kane munguar por nuk ka patur gola te tjere. Nuk kane munguar rastet, madje edhe shtyllat por topi nuk ka perfunduar me ne rrjete. Perfundimisht 2-1 per Vllaznine e cila rikthehet te kete shpresa per qendrimin ne Superlige. Percaktuese tashme do te jete sfida e saj ne Korçe me Skendebeun dhe mbi te gjitha ndeshja e Partizanit ndaj Kamzes.

© vllaznia.al